



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 88/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.02.2019 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “A.E.K Security” shpk në procedurën e prokurimit me Nr. REF-83439-08-20-2018, me objekt: “Shërbim i ruajtjes së pronës për Albpetrol sha në Qarkun Berat” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 10.632.200,4 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 27.11.2018, nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

Autoriteti kontraktor: Albpetrol sh.a, Patos, Fier.
Adresa: Lagja “29 Marsi”, Patos, Selia Rruga Fier – Patos, km 7, Fier.

Ankimues “A.E.K Security” sh.p.k
Adresa: ish-Kombinati i Tekstileve, Berat.

Subjekte të interesuar: “Myrto Security” sh.p.k
Lagja “Kastriot”, Rruga “Brigada e 11 Sulmuese”, Godina e Albtelecom, Fier.

“Nazeri 2000” sh.p.k
Rruga e Kavajës, Qendra Condor, Kati II, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të

Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.08.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit me Nr. REF-83439-08-20-2018, me objekt: “Shërbim i ruajtjes së pronës për Albpetrol sha në Qarkun Berat” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 10.632.200,4 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 27.11.2018, nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

II.2. Në datën 27.11.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor

në datë 24.12.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. "Aulona Pol I" sh.p.k.	Pa ofertë	skualifikuar
2. "A.E.K Security" sh.p.k.	242.993,87 lekë	skualifikuar
3. "Myrto Security" sh.p.k.	242.993,87 lekë	kualifikuar
4. "Nazeri 2000" sh.p.k.	242.993,87 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 24.12.2018, operatori ekonomik "A.E.K Security" shpk është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyet si më poshtë vijon:

OE ka paraqitur gjithsej 17 certifikata për punonjës shërbimi por certifikata e paraqitur për punonjës Viktor Kristaq Kovaçi me nr. 0214 është lëshuar në datë 29.10.2014 dhe ka datën e përfundimit 28.10.2018. Pra kjo certifikate është jashtë afatit dhe si e tillë konsiderohet e pavlefshme. Gjithashtu dy prej punonjësve të shërbimit për të cilët janë paraqitur certifikata të vlefshme (Neki Nazeraj dhe Planos Kadena) nuk figurojnë të siguruar në listëpagesën e muajit gusht, në kundërshtim me pikën 3.3 kapaciteti teknik germa "i" të DST-ve.

II.5. Operatori ekonomik "A.E.K Security" shpk, në datën 03.01.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

Në datën 27.11.2018 paraqitëm ofertën tonë në procedurën e prokurimit me objekt: "Shërbimi ruajtjes dhe sigurisë fizike të ambjenteve nën administrimin e Albpetrol sh.a, Berat".

Në datën 24.12.2018 pasi njihemi me klasifikimin e KVO-së konstatojmë se KVO-ja na ka skualifikuar me arsyen: "3 (dy) prej punonjësve të shërbimit për të cilët janë paraqitur certifikatat e vlefshme (Neki Nazeraj dhe Planos Kadena) nuk figurojnë të siguruar në listëpagesën e muajit gusht, në kundërshtim me pikën 3.3 kapaciteti teknik germa "i" të DST-ve". (ndërkohë që pika 3.3 kapaciteti teknik kërkon AKEP-in e shoqërisë).

Në ankesën tonë në datë 29.12.2018 ankimojmë pranë autoritetit kontraktor me arsyen se në pikën 3.1 të dokumentave të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit kërkojnë 15 certifikata të vlefshme punonjësish dhe shoqëria jonë e ka përmbushur më së miri këtë kërkesë, duke paraqitur certifikatat përkatëse dhe vërtetimin e DPQ-së Berat. Emrat në listën e vërtetimit përputhen me certifikatat e paraqitura. Pra theksojmë dhe njëllojë që "A.E.K Security" shpk i ka kapacitetet teknike për plotësimin e këtij kriteri. Në pikën 3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit kërkojnë 20 punonjës të siguruar për tre muajt e fundit të shoqëruar me listëpagesat e tremujorit të fundit. Edhe këtë kriter shoqëria jonë e ka përmbushur me sukses dhe në mënyrë korrekte, duke paraqitur si vërtetimin E-sig, ashtu si dhe listëpagesat me mbi 20 punonjës të siguruar. Pretendimi juaj i skualifikimit për 2 (dy) punonjës me certifikata të vlefshme që nuk figurojnë në listëpagesën e muajit gusht, por vetëm në shtator dhe tetor nuk qëndron ligjërish. Nuk ka ligj dhe nuk është e detyrueshme që personat që punojnë aktualisht pranë shoqërisë sonë apo të një shoqërie tjetër të kenë qënë në punë dhe tre muajt e fundit. Në bazë të Kodit të Punës dhe Ligjit 75/2014 "ligji për shoqëritë e ruajtjes dhe sigurim privat" shoqëria jonë mund të kryejë lëvizjet e fuqisë punëtore pa limit (largimet, pushimet nga puna, lejet pa të drejtë rroge, etj). Pra normalisht pa shkelur asnjë kapacitet teknik

shoqëria mund të ketë pasur marrdhënie pune (siguruar) 20 punonjës të caktuar gjatë tre muajve të fundit dhe në këtë moment mund t'i ketë larguar të 20 punonjësit (jo vetëm 2) dhe të marrë në punë 20 punonjës të tjerë me çertifikata të vlefshme të ushtrimit të profesionit. Rëndësi për juve, ligjin dhe procedurën e prokurimit nuk kanë emrat, por numrat (kapacitetet). Në nenin 2 të LPP përcaktohet qartë se: “Autoriteti kontraktor duhet të shmangi çdo kriter, kërkesë apo procedurë që lidhet me skualifikimin e operatorëve ekonomik që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo konkurentëve. Specifikimet teknike duhet të përgatiten qartë për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë ofertuesve.”.

Në mënyrë të përmbledhur të argumentave ligjorë të sipërcituar qartësojmë se autoriteti kontraktor domosdoshmërisht duhet të bëjë të mundshme trajtim të drejtë, jo diskriminues, si dhe jo preferencial të ofertuesve që marrin pjesë në procedurë pa u bërë selektiv. E ritheksojmë që pretendimi i skualifikimit nuk qëndron ligjërisht.

Mbi të gjitha ky skualifikim duket i qëllimshëm dhe qesharak për të paracaktuar fituesin duke shkelur hapur dhe rëndë barazinë në tendera, gjë që në rast moskualifikimi do të na detyrojë ta ndjekim dhe në procedurë ligjore penale përveç asaj administrative.

Nga sa më sipër kërkojmë:

- Pranimin e ankesës së operatorit ekonomik “A.E.K Security” shpk.
- Ndryshimin e klasifikimit të datës 24.12.2018 për operatorin ekonomik “A.E.K Security” shpk me statusin “refuzuar/skualifikuar, duke e “pranuar/kualifikuar” këtë operator

II.6. Me anë të shkresës nr.15/1 prot., datë 10.01.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar atë me pretendimet e mwposhtme:

Në formularin e ankesës ju si operator ekonomik kërkonti pranimin e ankesës dhe ndryshimin e klasifikimit të datës 24.12.2018 për operatorin ekonomik “A.E.K. Ssecurity” me statusin “refuzuar /skualifikuar” duke e “pranuar/kualifikuar” këtë operator.

Në lidhje me këtë pikë, ju si operator ekonomik ankimues pretendoni se skualifikimi i bërë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk qëndron.

Ju si operator ekonomik ofertues keni paraqitur ofertën tuaj më datën 24.11.2018 në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim i ruajtjes së pronës për Albpetrol sha në Qarkun Berat”, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj.

Në dokumentat standart të tenderit, (termat e referencës dhe specifikimet teknike) kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 3.3 Kapaciteti teknik, shkronja “h”, për këtë procedurë prokurimi është kërkuar që operatorin ekonomik duhet të plotësojë ndërmjet të tjerash edhe këto kritere: “Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit për jo më pak se 15 punonjës, shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë. Operatori ekonomik duhet të ketë

minimalisht 20 punonjës të siguruar në muaj, 15 punonjës shërbimi roje, si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin”.

Operatori ekonomik “A.E.K. Security”, ka paraqitur gjithsej 17 çertifikata për punonjës shërbimi, por çertifikata e paraqitur për punonjës Viktor Kristaq Kovaci me nr.0214 është lëshuar në datën 29.10.2014 dhe ka datën e përfundimit 28.10.2018, pra kjo çertifikatë është jashtë afatit dhe si e tillë konsiderohet e pavlefshme.

Gjithashtu Komisioni Vlersimit të Ofertave ka marrë në shqyrtim ofertat e paraqitura dhe ka konstatuar se operatori ekonomik “A.E.K. Security” për dy persona, punonjës shërbimi, për të cilët janë paraqitur çertifikata të vlefshme, përkatësisht shtetasit Neki Nazeraaj dhe Pianos Kadena nuk figurojnë të siguruar në listpagesën e muajit Gusht 2018. Ky fakt vjen në kundërshtim me kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 3.3 Kapaciteti teknik, shkronja “h”.

Është e vërtetë që KVO i është referuar në vendim, në lidhje me skualifikimin e bërë, pikës 3.3 shkronjes “i”. Në fakt refrenca e saktë është pika 3.3 e shkronjes “h” paragrafi i tretë, por ky përcaktim, nuk cenon themelin e vendimmarrjes për shkakun ligjor të skualifikimit të operatorit ekonomik “A.E.K. Security”.

Mbi bazën e përcaktimeve në Ligjin e Prokurimit Publik dhe Dokumentat Standarte të Tenderit i jepet mundësia operatorëve ekonomik që të plotësojnë kapacitetet profesionale dhe tenike në funksion të realizimit të kushteve të kontratës, sipas objektit të prokurimit.

Theksoj se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të vlerësojë ofertat vetëm mbi bazën e kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit dhe dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi në tender. Për sa u përket rezultuar se ju si ofertues ankimues keni dështuar të tregoni se punonjësit e shërbimit, për të cilët janë paraqitur çertifikata të vlefshme, përkatësisht shtetasit Neki Nazeraaj dhe Pianos Kadena të figurojnë të siguruar në listpagesën e muajit Gusht 2018. Pra ju si operator ekonomik nuk plotësoni në total numrin e punonjësve me certifikatë shërbimi të vlefshme, duke mosplotësuar kështu një nga kërkesat e përcaktuara në DST.

Për këto arsye, në zbatim të Nenit 63 e vijues të Ligjit, 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM Nr. 914, datë 29.14.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, si dhe bazuar në të gjitha materialet e dosjes së tenderit, autoriteti kontraktor, vendosi Të mos pranoië ankesën e paraqitur nga ana juaj për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim i ruajtjes së pronës për Albpetrol sha në Qarkun Berat”, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj.

II.7. Në datën 16.01.2019, operatori ekonomik “A.E.K Security” shpk, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 694/2 prot., datë 28.01.2019, protokolluar me tonën në datën 31.01.2019 me objekt “Dërgim Informacioni ” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “A.E.K Security” shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij me arsyetimin se: “Në ankesën tonë në datë 29.12.2018 ankimojmë pranë autoritetit kontraktor me arsyen se në pikën 3.1 të dokumentave të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit kërkojnë 15 çertifikata të vlefshme punonjësish dhe shoqëria jonë e ka përmbyllur më së miri këtë kërkesë, duke paraqitur çertifikatat përkatëse dhe vërtetimin e DPQ-së Berat. Emrat në listën e vërtetimit përputhen me çertifikatat e paraqitura. Pra theksojmë dhe njëherë që “A.E.K Security” shpk i ka kapacitetet teknike për plotësimin e këtij kriteri. Në pikën 3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit kërkojnë 20 punonjës të siguruar për tre muajt e fundit të shoqëruar me listëpagesat e tremujorit të fundit. Edhe këtë kriter shoqëria jonë e ka përmbyllur me sukses dhe në mënyrë korrekte, duke paraqitur si vërtetimin E-sig, ashtu si dhe listëpagesat me mbi 20 punonjës të siguruar. Pretendimi juaj i skualifikimit për 2 (dy) punonjës me çertifikata të vlefshme që nuk figurojnë në listëpagesën e muajit gusht, por vetëm në shtator dhe tetor nuk qëndron ligjërish. Nuk ka ligj dhe nuk është e detyrueshme që personat që punojnë aktualisht pranë shoqërisë sonë apo të një shoqërie tjetër të kenë qënë në punë dhe tre muajt e fundit. Në bazë të Kodit të Punës dhe Ligjit 75/2014 “ligji për shoqëritë e ruajtjes dhe sigurim privat” shoqëria jonë mund të kryejë lëvizjet e fuqisë punëtore pa limit (largimet, pushimet nga puna, lejet pa të drejtë rroge, etj). Pra normalisht pa shkelur asnjë kapacitet teknik shoqëria mund të ketë pasur marrëdhënie pune (siguruar) 20 punonjës të caktuar gjatë tre muajve të fundit dhe në këtë moment mund t'i ketë larguar të 20 punonjësit (jo vetëm 2) dhe të marrë në punë 20 punonjës të tjerë me çertifikata të vlefshme të ushtrimit të profesionit. Rëndësi për juve, ligjin dhe procedurën e prokurimit nuk kanë emrat, por numrat (kapacitetet). Në nenin 2 të LPP përcaktohet qartë se: “Autoriteti kontraktor duhet të shmangë çdo kriter, kërkesë apo procedurë që lidhet me skualifikimin e operatorëve ekonomik që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo konkurrentëve. Specifikimet teknike duhet të përgatiten qartë për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë ofertuesve.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit të modifikuar, Shtojca 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 3.3/, autoriteti kontraktor ka parashikuar se:

“Operatori ekonomik duhet të ketë paraqesë:

h) Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF, si dhe Dokumenti i Performacës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik.

Për këtë duhet të paraqesë **vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Berat** ku jepet informacioni i mësipërm i kërkuar.

- Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit për jo më pak se 15 punonjës, shoqëruar me **listëpagesat e sigurimeve shoqërore** (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë. Operatori ekonomik duhet të

ketë minimalisht 20 **punonjës** të siguruar në muaj, 15 punonjës shërbimi roje, si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.

- Që ka Grup të gatshëm.

(Vërtetimi të jetë i lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e hapjes së ofertave). ”.

III.1.2. Për përmbushje e kriterit të sipërpërmendur, lidhur me numrin e punonjësve të siguruar ofertuesi “A.E.K Security” shpk ka dorëzuar në SPE dokumentacionin e si më poshtë vijon:

- Vërtetim nr.3969/1 prot, datë 26.11.2018, lidhur me performancën e subjektit “A.E.K Security” shpk lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë, Berat.
- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Berat lidhur me numrin e punonjësve të punësuar pranë shoqërisë “A.E.K Security” shpk, për periudhën dhjetor 2015 – tetor 2018.
- Listëpagesat e punonjësve të shoqërisë “A.E.K Security” shpk, sipas formularit E-sig 025 a, përkatësisht si më poshtë:
Maj 2018 – 21 (njëzet e një) punonjës
Qershor 2018 – 28 (njëzet e tetë) punonjës
Korrik 2018 – 27 (njëzet e shtatë) punonjës
Gusht 2018 – 29 (njëzet e nëntë) punonjës.
Shtator 2018 – 31 (tridhjetë e një) punonjës.
Tetor 2018 - 31 (tridhjetë e një) punonjës.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.1.4. Në nenin 53, pika 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.5. Në nenin.66, pika.3, të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

III.1.6. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në procedurë lidhur me kërkesën e dhënë në dokumentat e tenderit në të cilën përcaktohet se ofertuesi duhet që të paraqesë: “Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit për jo më pak se 15 punonjës, shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 20

punonjës të siguruar në muaj, 15 punonjës shërbimi roje, si dhe drejtuesin teknik dhe administratori”, si dhe duke patur parasysh se procedura e prokurimit është zhvilluar më datë 27.11.2018, Komisioni konstatoi se ofertuesi me dokumentacionin e paraqitur plotëson kërkesën lidhur me numrin e punonjësve, pasi për tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës dhe përkatësisht për muajt gusht, shtator dhe tetor 2018 ka të punësuar një numër punonjësish më të lartë se ai i kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “A.E.K Security” shpk, mbi kundërshtimin e pjesës arsyetuese të arsyes së skualifikimit të dhënë nga KVO-ja, e cila shprehet se: *“Gjithashtu dy prej punonjësve të shërbimit për të cilët janë paraqitur çertifikata të vlefshme (Neki Nazeraaj dhe Planos Kadena) nuk figurojnë të siguruar në listëpagesën e muajit gusht, në kundërshtim me pikën 3.3 kapaciteti teknik germa “i” të DST-ve”;* Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 3, paragrafi i parë i tij, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, që përcakton se: “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “A.E.K Security” shpk se *“dy prej punonjësve të shërbimit për të cilët janë paraqitur çertifikata të vlefshme (Neki Nazeraaj dhe Planos Kadena) nuk figurojnë të siguruar në listëpagesën e muajit gusht, në kundërshtim me pikën 3.3 kapaciteti teknik germa “i” të DST-ve”,* është kryer mbi bazën e një kriteri të pakërkuar nga autoriteti kontraktor, duke qenë se ky i fundit nuk e ka parashikuar këtë kriter në DST. Në sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit në fjalë, e cila është bazuar mbi një kriter të pakërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, është e pavlefshme.

Në sa më sipër pretendimi i ankimuesit “A.E.K Security” shpk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “A.E.K Security” sh.p.k., për procedurën e prokurimit me Nr. REF-83439-08-20-2018, me objekt: *“Shërbim i ruajtjes së pronës për Albpetrol sha në Qarkun Berat” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 10.632.200,4 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 27.11.2018 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.*

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “A.E.K Security” shpk, duke e kualifikuar atë.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “A.E.K Security” shpk.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 72 Protokolli; Datë 16.01.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

